


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 05.09.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/21-15248/25
05.09.2025
Dragash - Dragaš

PROCESVERBAL

Dëgjimi buxhetor me qytetarë, i organizuar nga KPF
(Komiteti për Politikë dhe Financa)

Për Buxhetin e vitit 2026

I mbajtur më 04.09.2025 (e enjte)

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Dëgjimin buxhetor me qytetarë, i organizuar nga KPF (Komiteti për Politikë dhe Financa) për Buxhetin e vitit 2026 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 24.07.2025.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: *Opština Dragaš, 24.07.2025*
Boshnjakisht: *Opština Dragaš, 24.07.2025*

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: *Opština Dragaš, 24.07.2025*
Boshnjakisht: *Opština Dragaš, 24.07.2025*

Njoftimi në uebfaqen zyrtare: *Opština Dragaš, 24.07.2025*
Opština Dragaš, 24.07.2025

Dëgjimi buxhetor ka filluar në ora 11:00 dhe ka përfunduar në ora 11:40.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **24 pjesëmarrës, prej tyre 21 meshkuj dhe 3 femra.**

Takimi e hapi kryesuesja e Kuvendit të Komunës, njëherit edhe kryesuese e KPF-së, znj. Arijeta Skeraj e cila i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen.

Arijeta Skeraj: Fillimisht, më lejon që t'ju uroj mirëseardhjen dhe t'ju falënderoj që keni gjetur kohë për të marrë pjesë në këtë Dëgjim buxhetor. KPF-ja, si mekanizëm i Kuvendit të Komunës është i obliguar që, në bazë të dispozitave ligjore, të mbajë dëgjim publik me qytetarë për të shqyrtuar dhe prezantuar projekt-buxhetin e Komunës, të cilin e harton ekzekutivi lokal, duke u bazuar në dëgjimet buxhetore paraprake, kërkesat e qytetarëve dhe propozimet e këshillave të fshatrave. Projekt-buxheti na është dorëzuar nga kryetari i Komunës sipas afateve ligjore, para datës 1 shtator. Pas marrjes së ndonjë kërkesë apo propozimi eventuale nga ana juaj, ky dokument do të shkojë për miratim përfundimtar në Kuvendin e Komunës dhe duhet të votohet nga delegatët e Kuvendit, më së largu deri në fund të muajit shtator. Projekt – buxheti, duke përfshirë Listën preliminare të investimeve kapitale dhe dokumentet e tjera të nevojshme, është i publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, ku keni pasur mundësinë që ta shkarkoni dhe të informoheni lidhur me përmbajtjen e tij. Listën preliminare të investimeve kapitale besoj se e keni marrë edhe si kopje fizike këtu në sallë. Bazuar në projeksionet që janë bërë gjatë kësaj periudhe të hartimit të draft-buxhetit nga ekzekutivi, Buxheti total i Komunës së Dragashit parashihet të jetë rreth **13 milionë € 254 mijë € 882 euro**. Ky buxhet përbëhet nga dy shtylla kryesore: nga mjetet që vijnë nga grantet dhe mjetet që Komuna grumbullon si të hyra vetanake. Për vitin 2026, nga grantet janë paraparë rreth **12 milionë € 655 mijë € 154 euro (mjete që vijnë nga Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik i Arsimit dhe Granti Specifik i Shëndetësisë)**, ndërsa nga të hyrat vetanake të Komunës janë paraparë rreth **599 mijë € 728 euro**. Sa u përket investimeve kapitale, besoj se tashmë e keni të shpërndarë nga një kopje të Listës preliminare të investimeve kapitale dhe mund ta përcillni tabelën e shpërndarjes së mjeteve për të gjitha projektet e parapara. Të nderuar të pranishëm, para se ta kalojmë fjalën tek ju, për të marrë sugjerimet dhe rekomandimet tuaja lidhur me përmbajtjen e Propozim-buxhetit të Komunës së Dragashit, e lus anëtarin e KPF-së dhe zëvendëskryesuesin e Kuvendit, z. Munir Jonuzi, që ta marrë fjalën, nëse dëshiron që të shtoj diçka dhe t'ju drejtohet me një fjalë rasti!

Munir Jonuzi: Falënderit znj. kryesuese, më vjen mirë që e keni respektuar procedurën ligjore dhe e keni organizuar komitetin si dhe këtë debat publik me qytetarët para Komitetit për Politikë dhe Financa. Kjo flet për transparencën që ka vetë Komiteti, por edhe për transparencën e kësaj Asambleje. Dëshiroj që të gjithë qytetarët lirshëm t'i shprehin propozimet, kritikën dhe sugjerimet e tyre. Ne jemi

këtu që t'ju dëgjojmë dhe jam i sigurt se diçka nga ato do ta përfshijmë edhe në buxhetin për vitin 2026. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, të nderuar të pranishëm, tani është radha juaj, në qoftë se do ndonjëri prej jush që ta marrë fjalën rreth Projektbuxhetit.

Bekim Qusaj, përfaqësues i komunitetit shqiptar në Dragash: Përsëritet për të gjithë! Ne kemi disa kërkesa, që qytetarë të Komunës së Dragashit. Meqenëse Ujësjetësi për 15 fshatra së shpejti do të jetë në funksion, lagjja e re përmi bazenin, ku janë 21 shtëpi – krejt jemi shqiptarë, të Pllajnikut – ne jemi jashtë atij projektit, nuk na kanë paraparë në atë projekt. Ne për momentin jemi me sistemin e ujit që vjen prej Radeshës, me gyp të azbestit. Nëse kalon me fabrikën e re, atëherë ne jemi të pakëzuar në rrjet të ujësjetësit. Kjo është një kërkesë e qytetarëve, me na bo një zgjidhje, me na kyç edhe neve në rrjet, sepse mbesim keq pa ujë. Shumë domethënëse ka qenë pardje, në intervenimin më të shpejtë që na ka kris kanalizimi të shkollës “Ruzhdi Berisha”, intervenimi i kryetarit ka qenë shumë i shpejtë. Kemi reaguar në mënyrën më të mirë, me një kompani, e kemi bo meremetimin e krejt atij kanalizimit që ka hy brenda kanalit të kalldajës, edhe shkolla është funksionale. Të falënderoj shumë, kryetar për atë punë që e ke bo. Kërkesa e dytë është, Qendra për Punë Sociale dhe HANDIKOS nuk kanë pas ujë tërë verën. Ne ujin e kemi afër të spitali, gypi kapërcen deri të hidranti. Është një kërkesë që mujm me e bo një kyçje për këto institucione, edhe për vetë Komunën dhe disa objekte përreth që i ka Komuna. Është një kërkesë tjetër: Dragashi po rritet, për çdo ditë ka ndërtime të shtëpive të reja në të gjitha zonat, është një kërkesë e qytetarëve të Dragashit: kah rruga e Kukajanit është një gyp 75-sh, me ujë të pijshëm, për momentin ka ujë, është i mangët, është kërkesë edhe për një gyp më të madh me e shti. Janë ndërtuar mbi 30 shtëpi në atë zonë. Ndoshta edhe punonjësit e Inspektoratit që që merren me këto punë ju kanë njoftuar. Është kërkesë e nevojshme për një kyçje të ujit, një gyp të ujit më të madh me e çue në atë zonë kah rruga e Kukajanit andej. Kërkesa tjetër është të lagjja e re ku po thirret – në rrugë të Restelicës, ana e djathtë, nën ndërtesat e Lirës atje poshtë – me kanalizimin kanë problem. Pikërisht z.Besnik Beqiri, dy herë këtë vit i ka hy kanalizimi brenda në bodrum. Nëse ka mundësi edhe ka mjete, kjo do të ishte më me prioritet prej të gjithave. Ka pas dëme ai brenda bodrumit të shtëpisë aty, ku i ka pas ato materialet e ndërtimit, se punon kapak me ndërtim. Mos ta lëmë edhe këtë vit me hy, prej tash e deri në maj, se me të vërtetë do të bëhet problem. Që ka mundësi me i ndihmë këtij Besnikut. Ishte edhe kjo kërkesë e qytetarëve. Sepse zgjidhet një problem shumë i madh për atë zonën atje poshtë, lidhen mbi dhjetë shtëpi në atë rrjet të kanalizimit. Ne bashkë me punëtorët e Komunës kemi qenë, me këta të Zyrës së Kadastrit, kemi qenë i kemi marrë pikat, koordinatat, e kemi matur atë kanal in atje. Po shpresojmë këtë vit që të mund të bëhet diçka. Është edhe një kërkesë e një lagjes, prapë kah rruga e Kukajanit, kah shtëpia e Mujdin Çuftës, atje janë mbi

30 shtëpi, gypi është i vogël, i pamjaftueshëm për ujë. Këtë herë kemi pas dy intervenime, edhe në rrjet të ujësjellësit, edhe tri herë me kompaninë Krasniqi hapjen e kanalizimeve po në atë lagje atje. Sa herë i kemi thirrë, i kemi bo kërkesë Komunës, na kanë ofruar cisternën, e kemi bo hapjen e kanalizimeve. Nëse është e mundur edhe atje me intervenue, me një kanalizim të ri edhe me një rrjet të ri të ujit me e shti. Edhe kërkesa që është shumë e kërkuarshme prej qytetarëve të Dragashit, që shumë vite rresht, në të dy qeveritë, edhe në atë të mëhershmen, edhe të tashmen, qytetarët e kërkojnë atë shtëpinë turistike nëse është e mundur me u bo. Megjithatë keni qenë të hapur, keni thënë na bini projektin. E kemi thirrë Xhevdetin, po nuk ka qenë i gatshëm me ardhë prej Prishtinës veç për një projekt. Kështu ju keni qenë të gatshëm për me i fillue punimet. Të shprehim mirënjohje, unë gjithmonë po dal i pari, po më me prioritet nuk do të ishte kjo shtëpia sa do të ishte qe ky kanalizimi te Besnik Beqiri, të ishte zgjidhur. Po të lutem, që ke mundësi! Ajo familje dhe disa familje tjera lidhen aty, po dëmin më shumë ia ka bo Besnik Beqirit. Është në kushte jo të mira ekonomike. Koordinatat janë të marra, e matme është, Bëni diçka për këtë familje, se me të vërtetë ka nevojë. Kaq kisha unë! Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, siç e keni parë edhe në njoftimin që e kam shpërndarë, çdo qytetar ka të drejtë që edhe përmes emailit të dërgojnë komentet dhe kërkesat e tyre. Unë vetëm djë i kam pasur një prej fshatit Kosavë dhe prej fshatit Pllavë. Ju kisha lut, çdokush ka të drejtë të dërgoj komente, sugjerime dhe kërkesa derisa të dorëzohet në Kuvend Projektbuxheti.

Artan Loshaj: Përsëritetj Bećim Qusaj, përsëritetj punëtorë të Komunës. Zonja kryesuesë, kryetar, nuk po shoh unë asnjë qytetar këtu që kanë ardhë sot këtu në debat, përveć Bekrisë si përfaqësues i Dragashit. Pëmdryshë, ky nuk është takim me qytetarët, ky është takim me punëtorët e Komunës, me Administratën. Deshta me pyet, pasi që është buxheti, ku janë mediat, ku janë gazetarët? A janë të thirrur, pse nuk janë këtu? Buxheti është më i rëndësishëm, apo po doni me kalue već sa për performancën këm. Këtu nuk e kam rendin sot me folë, se jam asambleist, e kam Kuvendin nëpër mbledhje të Asamblesë. Qe dy muaj ditë po heshtni, në muajin korrik, gusht, edhe shtator nuk keni seanca. Pse frikësoheni prej qytetarëve, pse frikësoheni prej opozitës. Unë shumë do pika të shkurta për sot, se do të dal në seancë me folë. Po më vjen mirë që trysnia jeme edhe e qytetarëve të fshatit Rrenc e ka bo të mundshme që juve edhe kryetarit me jau largue ndërtimin e deponisë në fshatin Rrenc. Ky është një sukses i imi edhe i të gjithë qytetarëve. Tjetër send, këtu e pashë ndërtimin e kulmeve të ndërtesave në qytezën e Dragashit. Janë mbi 10 ndërtesa, me 30 mijë euro s'po di çka mundeni me ndërtue. Çfarë kulme mundeni me ndërtue. Nuk janë ato shtëpiat e Uzair Hamzës që po i bën për fushatë, kulme të shtëpive, ato janë kulme të ndërtesave. 3 mijë euro një kulm, është turp për

qytetarët me e qit këtu me e thonë. Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e fshatit Rrenc – ju kam thënë edhe më herët, kjo nuk është risi, por po due me jua rikujtue – dëmi që është bërë gjatë ndërtimit të rrugës Kapre-Rrenc, me ato paret e fshatit Rrenc shkoni me ndërtue murin mbi 100 metër, krejt buxhetin e fshatit po e harxhoni. Kryetari na premtue qe dy vite, vitin e kaluar, do ta bëjmë këtë vit, do ta bëjë këtë vit, e keni lënë në 2026-tën, edhe atë e keni lënë me pare të taksapaguesve të fshatit Rrenc. Atë mur mbrojtës duhet Komuna, bashkë me ata mbikëqyrësit e Komunës dhe me firmën ndërtuesë, me e kthye në gjendjen e mëparshme atë. Tjetra, është një shqetësim, e pashe rrugën Xërxe-Rrenc, 20 mijë euro, shumë mirë, po një kërkesë e qytetarëve të Rrencit edhe të gjithë qytetarëve të Komunës së Dragashit është që, rruga që e keni ndërtue për në Kapre shumë frekuentohet ajo, por prej te Lapidari deri në qendër është shumë ngusht, edhe po kemi probleme aty. Unë kërkoj që në buxhetin e 2026-tës urgjentisht, deri në fund të shtatorit, të bëjmë një matje të mirë, edhe një planifikim të mirë, edhe ta bëjmë zgjerimin e rrugës Lapidar-Ura e Haxhi Musës. Edhe, pasi ajo rrugë po frekuentohet shumë, është mirë bare shenjëzimin me e bo, se shumë qytetarë të Opojës që nuk po shkojnë mo okolla, por po shkojnë trup, aty po në rrezikojnë qytetarët. Edhe krejt në fund, te Lapidari aty, rruga Kapre që po shkon nëpër Rrenc, është mirë me bo shenja, kush ka përparësi aty me kalue, se do të bëhen aksidente, se veç ka pas probleme. Është mirë me e bo një rrethrotullim, ose një shenjë diçka, me tregue se cili qytetar ka të drejtë me kalue aty. Edhe një herë, faleminderit shumë, më në fund kokëfortësia juaj pak u zbut, se deponia më në fund s'po bëhet në fshatin Rrenc këtë vit, po e di që si ta merrni mandatin, vitin tjetër e qitni me e bo, po nuk kalon. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, z.Loshaj tha se nuk kemi mbajtur seancë në korrik e gusht. Artani është shumë i vetëdijshëm që gushti është pushim, por ndoshta e ka prej asaj egos që e bën. Në korrik është mbajtur seancë. Ne nuk i tutemi kërkujt, unë veç atij të madhit Zot i tutem. Për njerëz qetu në tokë që ka, nuk i tutem asnjë njerit. Kështu që, seancë do të kemi në fund të shtatorit, e di edhe vetë ai, se ka qenë do mandate, e di që buxheti sillet në Kuvend në shtator. Pse i bën këto, pse nuk i bën, nuk e di! E dyta, unë nuk dua këtu me u kap, jo me të, por me askënd. Por, gjithmonë thotë qytetarët, qytetarët. Në qoftë se janë këta punonjës të Komunës, janë qytetarë të Komunës së Dragashit. Në qoftë se nuk i sheh ti si qytetarë të Dragashit, atëherë qysh po i sheh punëtorë të Komunës. Këta kanë të drejtën, tash janë në paktun e qytetarit, ka të drejtë çdokush. Thajë veç një është, unë nuk po e shoh që është një: është Sueli, është Graniti, është Izeti, është Elmria, është Bekimi, është Nesimi. A janë të mjaftueshëm për ty, Artan, se ti i quajtur të gjithë. A ka mundësi që më me këto propaganda mos me u marrë. Mu po më vjen keq shumë që po bëjsh këso propaganda, por nuk të lejohet edhe mo s'po të dhez, qekjo është më e keqja.

Suel Ahmeti, banor i fshatit Bresanë: Përsëritet të gjithë! Si banor i fshatit Bresanë, kam ardhë me marrë pjesë në këtë dëgjim buxhetor edhe me tregue që një pjesë e madhe e projekteve në fshatin Bresanë janë implementuar. Po i ceki disa, të cilat qeveritë e mëhershme nuk i kanë bërë, ndërsa kryetari me ardhjen e tij i ka bërë: kubëzimi i rrugës prej Urës së Madhe deri te Xhamia e Re; renovimi i shkollës së re e cila ka pas nevojë; renovimi i AMF-së në Bresanë; përreth lumit në Bresanë e ka bërë murin mbrojtës, që vitin e kaluar kur ishin vërshimet, në mungesë të murit, lumi doli prej shtratit; projekti i fundit që e ka nis është para dy ditëve, në lagjen tonë e cila njëherë është edhe lagjia e cila u dëmtua nga vërshimet e fundit, ka filluar me e ndërtuar urën e re, me e zgjeruar urën e re, dhe e ka vërshuar murin mbrojtës përreth lumit. Një kërkesë individuale ndoshta, po edhe e banorëve, që AMF-në në Bresanë me e bëjë 24 orë me kujdestari. Nëse kish pas mundësi, për shkak se Bresana është si qendër dhe fshatrat përreth që janë gati 10 fshatra, për mos me ardhë në Dragash për shkak të rasteve që po janë të ndryshme, gjatë natës me e pas AMF-në në Bresanë, 24 orë në shërbim të kujdestarisë, pasi edhe që janë marrë shumë mjekë të rinj – kryetari në këtë drejtim ka punuar – edhe i ka plotësuar nevojat e qytetarëve, atëherë mundet edhe kërkesat të plotësojnë. Faleminderit!

Artan Loshaj: Nuk është vendi, kryesuese, këtu, se jemi me qytetarët, por nuk të kërcënova ty, se nuk merrem me ty unë. Unë të thashë pse po i tutnu fshatës. Ty kush nuk të kërcënoi. Edhe me këto sende mos u viktimizoj! Edhe kur folën unë, asnjëri prej tyre nuk ka, tash erdhën. Unë s'un i pres në fund, kush po vjen e kush po hi. Unë sa isha këtu, ishte vetë Bekimi. A ka mundësi mos me m'ndërpre kur të bisedoj unë? E kam një kërkesë për ty, sidomos - masi po e qesim në personale – në fshatin Rrenc mos e çoj burrin bedel me mat kubëzime për vota, mos blij vota me kubëza, nepotizmin kallxo çka ke bërë, sa ke punësuar të tutë. Qeshtu, e mos çoj natën, si ai Prindoni i Vjosa Osmanin, mos e çoj burrin bedel, ja kockën ja votën, ma japish votën, ta jap kockën, edhe sivjet i matish në mot t'i boj – a jeni në mot a nuk jeni, ai është problem tjetër. Kurrë nuk ka ndodhë ky problem, mos të lutem, kam incizime, kam video, kam sende. Ma jep votën, ta jap kockën, çele derën ta mat për në mot me e bërë. Kryesuese, nepotizmin, të motrës, të dajës, të tezes ke punësuar. Pse s'po e punësojsh një rrencjan për me marrë votë, jo me kubëza, jo me parë të qytetarit. Jo me dhunë me e marrë votën, të lutem!

Arijeta Skeraj: Atëherë, unë nuk do t'ia përmendi emrin, por sa për nepotizëm, shumë njerëz para meje kanë dalë me kryetarin, kanë folë, për me jua punësuar gruan këtu, po s'ju ka dëz. Kanë dalë në korr, vetë personi ka kallxuar që kanë dalë, por nuk iu ka dëz. Shumë herë më ka thënë je shit në PDK. Nuk jam shit unë në PDK, kur ka qenë Shaban Shabani këtu, kam votuar shumë herë kundër LDK-së për të mirën e qytetarit. Të qes s'un munde prej LDK-së me punësuar gruan edhe me marrë bancesë, ajo është dhunti që mu s'un ma kalojsh. Sa për bedel, shumë je i vogël ngat burrit tem, në krejt aspektet. Po më vjen keq me të thënë. Nëse ti ose dikush ka incizime, që burri im ka shkue e i ka thënë po t'i

vë kokat edhe ma qit votën, lirisht mundesh me bo. Veç mos harro, se kjo punë ka me shkue në gjykatë. Këtë nuk ta lejoj! Ti vetë mu m'ke thonë, te Citi, që me Bexhet Xheladinin kam dalë kam bo marrëveshje për me shti gruan në punë. Po ty s'un të kanë ble këta, se je shit shtrenjtë, e unë jam shit lirë. Ti ke lyp ma shumë se një banesë. Këtë ta dish, ke nis një fushatë të egër, po s'un ke me kalue. Sa për me u tut, jo unë si person, po edhe si LDK tu s'un ke me na mund, se ti je qaj që në KPI' i ke thënë Bexhet Xheladinit që kam me të votue edhe nuk kam me qenë kandidat. Vetë je kandidat, vetë po bëjsh propagandë për Bexhet Xheladinin, që nuk keni me mund edhe këtë mandat me e kalue.

Uzair Hamza: Respekt dhe përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Flas si përfaqësues i fshatit Kërstec. Dua të theksoj se për vitin 2025 kemi planifikuar projekte që lidhen me parkingun, si dhe për vitin 2026, për shkak të faktit se pas hapjes së pikës kufitare me Shqipërinë është rritur qarkullimi, ndërsa gjatë sezonit veror kemi automjete të parkuara përgjatë Kërstecit të poshtëm. Prandaj, mjetet që janë ndarë për vitin 2026 mendoj se nuk do të jenë të mjaftueshme për ndërtimin e edhe një parkingu tjetër. Në periudhën e ardhshme do të mundohemi të kërkojmë dhe të sigurojmë mjete shtesë, në mënyrë që rruga dhe qarkullimi të jenë të lirë sa i përket frekuencës së trafikut. Dua gjithashtu të theksoj projektin që po realizohet, sa i përket kulmeve – ai nuk është nga mjetet e komunës. Ky është projekt i banimit social, me qëllim të rritjes së efikasitetit energjetik. Komuna nuk ka lidhje me këtë projekt, dhe as mjetet prej 30.000 euro nga komuna për kulme nuk janë të komunës, por nga projekti të destinuara për këtë projekt.

Ardit Kalanderi, përfaqësues i fshatit Kosavë: Përshëndetje për të gjithë! Po flas në cilësinë e përfaqësuesit të fshatit Kosavë. Dola këtu vetëm me e theksue që, shumica e kërkesave që janë bërë nga unë në dëgjimin e kaluar buxhetor, janë realizuar apo janë në listën e shpenzimeve kapitale. Këto projekte që janë, shumica janë esenciale për jetën e qytetarëve, siç janë për shembull: rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, ndriçimi publik, ndërtimi i stadiumit, e kështu me radhë. Vetëm dola një falënderim publik me ia bo kryetarit!

Brendi Berisha, përfaqësues i fshatit Buqe: Përshëndetje për të gjithë! Unë deshta vetëm tek çështja e investimeve kapitale në fshatin Buqe, ne, për shkak të numrit të vogël të numrit të banorëve, edhe buxhet kemi zakonisht 60 mijë, aty sillet, na është desht për tri vite me bo investime në kanalizim, gjë që nuk e di pse ne kemi qenë në të kaluarën të hequr prej kësaj pjese edhe e kemi pas kanalizimin – çështjen elementare – të pafinalizuar. Tash, me ardhjen e kryetarit, na ka përkrah vazhdimisht, edhe pothuajse është i përfunduar kanalizimi në fshatin Buqe, duke marrë parasysh se ne pikën e derdhjes e kemi poshtë, gati në rrugën kryesore, edhe mbi 2-3 km na u desht në dy a tri akse me bo kanalizim. Një kërkesë e kemi për vitin e ardhshëm, po shpresojmë që me e krye edhe pjesën e ndriçimit, që është ndarë buxheti edhe po shpresojmë me e krye. Punët tjera, këto kryesoret që janë, janë krye. Një kërkesë

që e kemi pas të vazhdueshme, për hapjen e rrugës prej pjesës në mes të Buqes dhe Pllavës për në bjeshkë, me e krye përmes KFOR-it, ose diçka përmes Komunës. Unë kisha kërkuar, si kërkesë prej qytetarëve të fshatit Buqe, që kjo pjesë me u hap prapë edhe me u bo pjesë e rekreacionit dhe që shërben si për mbledhje të bimëve aromatike, për rekreacion, piknik etj. Po shpresoj që kemi me gjet edhe njëfarë mishi ndërmjet banorëve të fshatit Rapçë, Pllavë dhe Buqe, me e bo një kërkesë të përbashkët, pse jo, kjo rrugë që e lidh këtë pjesë tonën me Koretnikun, pse jo edhe me u asfaltue, me u zgjerue edhe me u asfaltue. Faleminderit, kryetar, për përkrahjen e vazhdueshme që e ke dhënë!

Reshat Alija, përfaqësues i fshatit Blaç: Përhëndetja për të gjithë! Unë desha vetëm të ju njoftoj se, në bashkëpunim me kryetarin por edhe me stafin këtu, kemi diskutuar për projektet që janë për fshatin Blaç, dhe desha të njoftoj se të gjitha projektet e planifikuara në Projektbuxhet për fshatin Blaç janë të inkorporuara në buxhet. Në këtë rast, deshta që ta falënderoj kryetarin për bashkëpunimin! Faleminderit shumë!

Munir Jonuzi: Faleminderit znj. Kryesuesel Ne, nga fshati Rapçë, kemi dorëzuar një kërkesë në shërbimin publik, në Zyrën e Protokollit, dhe atë kërkesë z. kryetar, ashtu edhe ju znj. kryesuese, do ta marrni në formë të shkruar lidhur me projektet kapitale që duhet të përfshihen për fshatin Rapçë në buxhetin e vitit 2026. Dalja ime në këtë foltore ishte për atë që përfaqësuesi i Buqes, z. Brendi Berisha, tha për rehabilitimin e rrugës Rapçë-Buqe. Në gjatë verës kemi mbajtur një takim me të gjithë qytetarët. Një nga këto projekte që qytetarët, përkatësisht banorët e fshatit Rapçë, dëshirojnë të realizohet në periudhën e ardhshme është pikërisht ky rehabilitim i rrugës, përkatësisht lidhja ndërmjet Rapçës dhe Buqes. Prandaj, ftoj përfaqësuesit e Buqes që bashkë me ne të dorëzojmë një kërkesë me shkrim që kjo të realizohet sa më shpejt. Ne e kemi planifikuar këtë, pasi kemi probleme me ujin, me rrjetin e ujësjellësit, dhe e kemi menduar që kjo të bëhet në një periudhë të ardhshme. Por, ja ku është thirrja nga fshati Rapçë që të dërgojmë kërkesë për lidhjen, për rehabilitimin e rrugës ndërmjet Rapçës dhe Buqes. Faleminderit!

Bekim Qusaj, përfaqësues i komunitetit shqiptar në Dragash: Prapë dola në foltore që ta përsëris! Është kërkesë – tash fola në telefon, sa më thirrën – për këtë lagjen të ndërtesat e Lirës ku e ceka, të shtëpia e këuj Besnik Beqirit, të marrni me prioritet, ju kisha lut! Gypat e kanalizimit një kompani i ka shkarkue aty. Nëse ka buxhet Dragashi, lëni diçka anash, realizojeni këtë kanalizim, se me të vërtetë është kërkesë e asaj familjeje. Ka pas problem – veç ju tregova më herët – me kanalizimin. Po lutem, po thonë që Komuna me e realizue. Lëreni ndonjë projekt të kockave apo ndonjë trotuar dikund anash, bëjeni këtë kanalizim, ta kryejmë sivjet për Dragash, masi veç janë krye mbi 90% të punimeve, të realizume janë, edhe qytetarët janë të kënaqur në krejt lagjet e Dragashit. Nëse e marrni me prioritet për me e krye, kishte me qenë shumë e qëlluar qekjo punë. Kaq kisha! Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë, ishin disa kërkesa, edhe kryetari i ka shkruar, në qoftë se do me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Unë nuk desha që ta marr fjalën, sepse unë i kam mbajtur dy dëgjime buxhetore me qytetarë. Normal që jemi në procesin e përgatitjes së buxhetit – edhe këto lista që i keni marrë janë ende projeksione, këto edhe mund të ndryshojnë, mund të plotësohen, varësisht prej kërkesave tuaja. Por, vetëm deshta të sqaroj – sepse pat këtu edhe diskutime se dikush gjoja po lyp vota për kubëza – unë kështu informata nuk kam deri më tash. Unë çdo herë kam thënë që kubëzimi i rrugëve dhe infrastruktura nuk janë çështje partiake. Infrastruktura është çështje qytetare që e shfrytëzojnë të gjithë. Kubëzimi i rrugëve, ndriçimi publik, kanalizimi, ujësjellësi, shkollat, çerdhet etj., janë investime që i shfrytëzojnë të gjithë qytetarët dhe janë për të mirën e të gjithëve. Unë e kam pas si premtime elektorale që gjatë mandatit tim të përfundojë kubëzimi i të gjitha rrugëve brenda vendbanimeve, gjithashtu edhe ndriçimi publik, kanalizimet dhe ujësjellësit. Këto deri 90% kemi arritur t'i bëjmë, ndërsa me buxhetin që e kemi paraparë për vitin e ardhshëm, të gjitha kubëzimet, në të gjithë territorin e Komunës së Dragashit brenda lokaliteteve do të përfundojnë. Faleminderit për organizimin e këtij takimi! Ju falënderoj edhe juve për pjesëmarrjen! Normal, pjesëmarrja nuk është e kënaqshme, por megjithatë kishte shumë përfaqësues të fshatrave të cilët e morën fjalën. Megjithatë, fajë nuk është i yni, ne njoftimet i kemi bërë me kohë, bile i kemi përsëritur disa herë, por qytetarët nuk janë edhe shumë të interesuar. Arsyeja ndoshta është se e kanë një besim shumë të madh tek ne, që po e përgatitim buxhetin mirë, po e ndajmë mirë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, e mbyllim këtë takim! Ju faleminderit për pjesëmarrjen!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <http://www.gjendendje.gov.al/ncs/komiteti-per-pardhese-dhe-familje-ta-dejte-sel-detyrim-ni-dedek-drejtuesit-nivello-komunal-ni-01-01>

Boshtnjakisht: <http://www.gjendendje.gov.al/ncs/komiteti-per-pardhese-dhe-familje-ta-dejte-sel-detyrim-ni-dedek-drejtuesit-nivello-komunal-ni-01-01>

Në Facebook:


Shqip: <http://www.facebook.com/TeShpirtVard>

Boshtnjakisht: <http://www.facebook.com/TeShpirtVard>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 04.09.2025

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME
QYTETARË TË ORGANIZUAR NGA KOMITETI PËR POLITIKË DHE
FINANCA

LISTA UÇESNIKA BUDŽETSKO SASLUŠANJE SA GRAĐANIMA
ORGANIZOVANO OD STRANE KOMITET ZA POLITIKU I FINANSIJE

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište	Etnička pripadnost	M	Ž	Potpis
1	Artan Lohaj	Dragash	Shqiptar	M		[Signature]
2	BEKRI QULAJ	Dragash	Shqiptar	M		[Signature]
3	Merybe Ramadani	Zaplluxhe	shqiptare	F	✓	M. Bex
4	Emedina Heani	Dragash	Shqiptare	F	✓	[Signature]
5	LIUBITA PIRRI	Dragash	Shq.	F	✓	[Signature]
6	Behar Selmani	KURU	shqiptar	M		[Signature]
7	RESHAT ALIJA	BLAQ	SHQIPTAR	M		[Signature]
8	SHADAN SKENDER	BREUT	SHQIPTAR	M		[Signature]
9	Veton Haliti	Zaplluxhe	Shqiptar	M		[Signature]
10	Rilav Igum					[Signature]
11	Uzon Hamet	Kristac	BOŠNAK	M		[Signature]
12	Brendi Beqir	Pase	SHQIPTAR	M		[Signature]
13	ARDIT KALLVOERI	Kosovë	Shqiptar	M		[Signature]
14	FLORENT ZUPATI	BRESAN	SHQIPTAR	M		[Signature]
15	Suel Ahmeti	Brelan	SHQIPTAR	M		[Signature]
16	Gjani Rendi	Brelan	Shqiptar	M		[Signature]
17	EMRI NEKATI	DRAGASH	Shqiptar	M		[Signature]
18	NEŠIM NESIMI	BRESAN	SHQIPTAR	M		[Signature]
19	Artis Idrizi	Kumshere	Bošnjak	M		[Signature]
20	IZET SKENDEROSI	BRED	Bošnjak	M		[Signature]
21	Edlir Rendi	Dragash	Shqiptar	M		[Signature]
22	Avzir Pateu	Rejdelica	Bošnjak	M		[Signature]
23	FARI KOLLONI	KOSOVË	Shqiptar	M	✓	[Signature]
24	Floria Hysa	Shafar	Shq.	M		[Signature]
25						
26						

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/04-15248/25
04.09.2025
Dragash - Dragaš

